



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.715/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësua (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevcu dhe Ferki Xhaferi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Plator Asllani, kandidat për Kuvend Komunal nga rradhët e Iniciativa Qytetare për Obiliq, dega në Obiliq, të paraqitur kundër Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, me objekt të çështjes, verifikim i rezultateve, për Zgjedhjet Lokale të 17.10.2021 në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pa palejuar ankesa Anr.715/2021, të datës 22.10.2021, të paraqitura nga Plator Asllani, kandidat për Kuvend Komunal nga rradhët e Iniciativa Qytetare për Obiliq, dega në Obiliq, për verifikim të rezultateve në vendvotimet 1501E/09D, 1510E/01R, 1510E/02R, 1502E/01R, 02R-03R-04R, 1520E/01R, 1520E/02D, 1507E/01R, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 22.10.2021, ka pranuar ankesën Anr.715/2021, nga Plator Asllani, kandidat për Kuvend Komunal nga rradhët e Iniciativa Qytetare për Obiliq, dega në Obiliq, në të cilën pretendon se pas publikimit të Formularëve të Rezultateve për Kandidat-FRK, të Kuvendit Komunal nga KQZ, ka vërejtur se mungojnë votat e familjarëve të cilët përmes deklaratave të tyre deklarojnë se kanë votuar, dhe se kërkon që të rinumërohen fletëvotimet në këto qendra të vendvotimeve: 1501E/09D në Obiliq, 1510E/01R, 1510E/02R në Mazgit të Epërm, 1502E/01R, 02R-03R-04R në Milloshevë, 1520E/01R, 1520E/02D në Mazgit i Ulët, dhe 1507E/01R në Babimoc.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë në vendvotimet nr. 1501E/09D, 1510E/01R, 1510E/02R, 1502E/01R, 02R-03R-04R, 1520E/01R, 1520E/02D, 1507E/01R, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljës së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesave nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljës të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 715/2021 më datën 25.10.2021

Kryesuesi i Panelit

Zyber Haxhi



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*